

Dëgjimi i zërit të qytetarit në dialogun e lehtësuar nga BE-ja mes Kosovës dhe Serbisë

Prishtinë, 6 shkurt 2015

Vendosja e marrëdhënieve stabile mes Kosovës dhe Serbisë është penguar nga dështimi i dialogut të nivelit të lartë mes shteteve për t'i dhënë mundësi shoqërisë civile dhe komuniteteve që t'i ngrisin shqetësimet e tyre. Komunikimi i dobët dhe mungesa e transparencës nga ana e palëve negociuese ka shpjerë në interpretime dhe pritshmëri të ndryshme sa i përket ndikimit që do të ketë Marrëveshja e Brukselit, si dhe ka rritur mosbesimin dhe tensionet mes njerëzve.

Para dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian (BE) që do të rifillojë me 9 shkurt 2015, përmes këtij dokumenti kërkohet nga kryeministri i Kosovës, kryeministri i Serbisë dhe Përfaqësuesja e lartë e BE-së për politikë të jashtme dhe siguri që të përmirësohet mënyra e menaxhimit të dialogut, përmes përfshirjes së shoqërisë civile, e cila do të mundësojë ofrimin e pikëpamjeve, pritjeve dhe shqetësimeve të komuniteteve lidhur me marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë. Përmes kësaj komunikate kërkohet nga palët negociuese që të krijojnë standarde të reja të transparencës si dhe të trajtojnë shqetësimet e njerëzve për efektet e mundshme të Marrëveshjes në jetën e tyre. Pa këtë impuls, ekziston rreziku që ndasitë etnike të rezultojnë me dhunë të re, duke rrezikuar kështu përparimin në procesin e pajtimit mes Kosovës dhe Serbisë.

Konteksti

Si pjesë e përkushtimit të BE-së për krijimin e marrëdhënieve stabile mes Kosovës dhe Serbisë, dialogu i lehtësuar nga BE-ja mes dy shteteve është gati që të rifillojë. Ky dialog sfidues, i lehtësuar nga Përfaqësuesi i lartë i shërbimit evropian për veprim të jashtëm (EEAS), ka filluar në mars të vitit 2011 dhe ka rezultuar me miratimin e "marrëveshjes së parë për parimet që e rregullojnë normalizimin e marrëdhënieve", e njohur edhe si Marrëveshja e Brukselit, në prill të vitit 2013. Marrëveshja synon të zgjidh mosmarrëveshjet ekonomike, sociale dhe politike, ndërsa përparimi në zbatimin e saj pritet që t'i kontribuojë ngritjes së perspektivës së të dyja shteteve për integrimin në BE dhe përmirësimin e paqes dhe stabilitetit në rajon.

Vizitat e nivelit të lartë të zyrtarëve të lartë qeveritarë të Serbisë të bëra kohëve të fundit në Kosovë, dhe vizitat në Serbi nga ata të Kosovës, shënojnë lëvizje të re dhe tregojnë përkushtim nga të dy qeveritë "e reja" për t'i vazhduar përpjekjet drejt normalizimit të marrëdhënieve mes dy shteteve. Vizita e ministrit të Kosovës për punë të jashtme, Enver Hoxhaj, në Serbi, gjatë së cilës ai morri pjesë në një konferencë rajonale të organizuar nga BE-ja, është konsideruar të jetë historike meqë ishte vizita e parë zyrtare e një ministri që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. Kryeministri i Serbisë Aleksandar Vuçiq bëri vizitë në Kosovë gjatë muajit janar të vitit 2015.

Megjithatë, deklaratat¹ e bëra nga zyrtarët qeveritarë të Serbisë gjatë vizitës së tyre në Kosovë nxitën reagime, ndërsa një përpjekje e pelegrinëve serbë nga Beogradi për ta vizituar një kishë ortodokse në Gjakovë provokoi protesta - duke i zbuluar kështu plagët e pashëruara në Kosovë dhe marrëdhëniet e brishta mes dy shteteve. Protestat masive, të cilat shpejtë u shndërruan në të dhunshme, pasuan në Prishtinë pas deklaratave² fyese të ministrit të Kosovës Jabllanoviq në drejtim të protestuesve shqiptarë të Kosovës të cilët ishin mbledhur kundër pelegrinëve serbë. Ky incident rezultoi në shkarkimin e ministrit Jabllanoviq³. Në Kosovë janë paralajmëruar edhe protesta të tjera rreth temave të ndjeshme që kanë të bëjnë me takimet e radhës të dialogut në Bruksel. Të shoqëruara me numrin gjithnjë në rritje të grevave dhe kërkesave ndaj Qeverisë së Kosovës për përmbushjen e zotimeve, dhe ngritjen dramatike të numrit të personave që po dalin nga Kosova

¹<http://www.balkaneu.com/kosovo-cradle-serbia-pm-vucic/>

²<http://www.presstv.ir/Detail/2015/01/28/395042/Protests-turn-violent-in-Kosovos-capital-->

³<http://www.reuters.com/article/2015/02/03/us-kosovo-minister-idUSKBN0L726C20150203>

për të shkuar në mënyrë të paligjshme në shtetet e BE-së, këto protesta e tregojnë nivelin e frustrimit të popullit, mungesën e perspektivës dhe durimin që po humbë.

Që nga fillimi, palët e përfshira në këtë dialog të nivelit të lartë nuk kanë arritur që organizatave të shoqërisë civile dhe komuniteteve lokale t'ua japin mundësi që t'i paraqesin shqetësimet dhe pritshmëritë e tyre lidhur me dialogun. Kështu që dialogu kryesisht është zhvilluar vetëm në kuadër të fushëveprimit të “dy personave”. Mungesa e transparencës dhe e komunikimit nga palët negociuese ka rezultuar në dykuptimësi rreth asaj që është dakorduar dhe rreth ndikimeve të mundshme në teren. Interpretimet e ndryshme dhe kontraverse të Marrëveshjes po krijojnë nivele të ndryshme të pritjeve, gjë që po shpije në skepticizëm, ndarje, polarizim të opinionëve, mosbesim, dhe tensione. Për shembull, në Beograd dhe në veri të Kosovës ka pasur deklarime se “Asociacioni/Bashkësia e komunave serbe të Kosovës”, që do të themelohet në Kosovë në bazë të Marrëveshjes, do të ketë kompetenca ekzekutive dhe legjislativë. Ngjashëm me këtë, disa parti politike, analistë dhe pjesëtarë të shoqërisë civile në Kosovë kanë paralajmëruar se veriu i Kosovës është duke u shndërruar në Republika Srpska, dhe kështu do të krijohet gjendje jofunksionale që do ta destabilizojë më tej shtetin.

Mungesa e transparencës dhe e komunikimit rreth dialogut dhe mungesa e një vlerësimi gjithpërfshirës mbi ndikimet e marrëveshjeve të (mos) zbatuara janë kritikuar në shumë raste. Në një raport të nxjerrë nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) thuhet se “marrëveshjet janë bërë prapa dyerve të mbyllura të kancelarive të Brukselit. Ndonëse në parim është e ditur se për çka janë arritur marrëveshjet, shpeshherë, informatat e plota rreth takimeve dhe marrëveshjeve të bëra nuk arrijnë deri tek qytetarët.”⁴ Aty po ashtu theksohet se në rastet kur procesi nuk është shpjeguar në tërësi në marrëveshje, si për rastin e themelimit të “Asociacionit/Bashkësisë të komunave serbe të Kosovës” dhe për sistemin e ardhshëm të drejtësisë, përparimi ka ngecur. Në një dokument të lëshuar nga PAX for Peace theksohet se dialogu “në mesin e komuniteteve të ndryshme në Kosovë perceptohet si kuti e zezë, që del me zgjidhje gjysmake”⁵ dhe një raport i përbashkët i përgatitur nga Forumi për Siguri (FS) në Prishtinë dhe Forumi për Parandalimin e Konfliktit në veri të Kosovës cek se “njerëzit nuk janë të informuar rreth ndikimeve të mundshme të menjëhershme dhe afatgjata të marrëveshjeve mbi jetën e tyre.”⁶

Zgjedhjet dhe zhvillimet politike në BE, Kosovë dhe Serbi gjatë vitit 2014 rezultuan me ndryshime në udhëheqësinë politike, ku në Kosovë dhe Serbi kryeministër të rinjë morën detyrë dhe pati ndryshime në postin e Përfaqësuesit të lartë të BE-së për politikë të jashtme dhe siguri, që tani kryesohet nga Federica Mogherini. Dy kryeministër - Isa Mustafa (Kosovë) dhe Aleksandar Vuçiq (Serbi) dhe zëvendësit e tyre Hashim Thaçi (Kosovë) dhe Ivica Dačić (Serbi) – do të takohen me Federica Mogherini në Bruksel më 9 shkurt 2015 për ta filluar roundin e ardhshëm të dialogut, për çka agjenda ende nuk është bërë publike.

Kalimi nga dialogu “mes dy personave” në dialog “me qytetarët në qendër”

Është e rëndësishë thelbësore që procesi nacional i dialogut të jetë i informuar dhe t'u përgjigjet nevojave e shqetësimeve të komunitetit nëse përmes këtij dialogu synohet të trajtohen çështje të pazgjidhura dhe të kontribuohet në paqe afatgjatë dhe stabilitet në regjion. Në kuadër të këtij procesi duhet të trajtohen seriozisht shqetësimet e qytetarëve lidhur me efektet e mundshme të menjëhershme dhe afatgjata të marrëveshjeve në jetën e njerëzve. Dy negociatorët (ekipet) e rinjë dhe lehtësuesi (lehtësuesit) nga BE-ja nuk duhet t'i përsërisin gabimet e paraardhësve të tyre, por duhet t'i zbatojnë në vazhdimësi parimet e transparencës dhe të gjithpërfshirjes. Ata duhet të inkurajojnë dhe të promovojnë procese më të mira konsultative dhe mekanizma për llogaridhënie më të madhe në zbatimin e marrëveshjeve, përfshirë përmes raportimit parlamentar.

Përveç kësaj, ata duhet të zhvillojnë një dialog shtetëror të hapur dhe konstruktiv me akterët e shoqërisë civile në mënyrë që ata t'i kuptojnë dhe të reagojnë më mirë ndaj shqetësimeve të popullit, që përfshijnë lirinë e lëvizjes, njohjen e diplomave universitare, ndikimin e marrëveshjeve në vendet e punës së njerëzve, funksionimin e policisë dhe të drejtësisë në veri, themelimin dhe funksionimin e “Asociacionit/Bashkësisë të komunave serbe në Kosovë”, dhe çështjet e tjera me ndjeshmëri të lartë, siç është

⁴<http://birn.eu.com/en/file/show/BIG%20DEAL%20FINAL%20ENG.pdf>

⁵ Veriu i Kosovës në vitin 2020 – e ardhmja në krijim nga PAX for Peace, Maj 2014.

⁶<http://www.saferworld.org.uk/resources/view-resource/790-peoples-views-on-key-peace-and-security-issues-in-kosovo>

ajo e personave të pagjetur. Krijimi i hapësirës që OShC-të të jenë pjesë aktive e ofrimit të perspektivave të komuniteteve në dialog në mënyrë të bashkërenduar dhe menaxhuar mirë do të kontribuojë në ndërtimin e konsensusit më të gjerë dhe në ngritjen e besimit dhe të ndjenjës së pronësisë në këtë proces. Poashtu, kjo do të ndikoj edhe në ngritjen e potencialit për marrëdhënie më të mira në të gjitha nivelet – jo vetëm në ato politike – gjë që do të kishte ndikim të shumëfishtë.

Andaj, është thelbësore që të përfitohet nga përparimi i arritur në dialog kohëve të fundit meqë ekziston një mundësi e mirë e zgjidhjes së dallimeve përmes zbatimit efektiv të marrëveshjeve. Një shoqëri civile proaktive dhe e informuar mund të luajë rol domethënës për ta mundësuar këtë. Nëse ky impuls humbet, ekziston mundësia që ndarjet etnike dhe pakënaqësitë të shpien në protesta të reja të dhunshme dhe të përsëritshme, gjë që paraqet kërcënim për përpjekjet e mëtejme për pajtim.

Rekomandimet

- Kryeministri i Kosovës dhe ai i Serbisë duhet të mbajnë takime të rregullta konsultative me akterët e shoqërisë civile, për t'i informuar ata rreth përmbajtjes së dialogut dhe për t'u angazhuar me ta në mënyrë konstruktive për përfshirjen e pikëpamjeve dhe të shqetësimeve të qytetarëve në procesin e dialogut. Kjo do ta ngriste mundësinë për mbështetje më të madhe nga qytetarët dhe për zbatim më efektiv.
- Kuvendi i Kosovës dhe ai i Serbisë duhet t'i ushtrojnë rolet e tyre mbikëqyrëse dhe të kërkojnë raportime nga kryeministrat rreth progresit dhe sfidave që ndërlidhen me dialogun dhe zbatimin e marrëveshjeve aktuale dhe të ardhshme.
- Palët e përfshira në dialog duhet të ndajnë kohë për të siguruar qartësinë e përmbajtjes së takimeve të ardhshme të dialogut dhe të procesit për zbatimin dhe vlerësimin e progresit, para arritjes së marrëveshjeve të ardhshme për të mënjanuar çdo paqartësi dhe vonesë.
- Ambasadat e jashtme dhe donatorët duhet të mbështesin një dialog mes kryeministrave/qeverisë dhe akterëve të shoqërisë civile në Kosovë dhe Serbi dhe të promovojnë parimet dhe vlerat e BE-së mbi transparencën, gjithpërfshirjen dhe llogaridhënien e qeverive.
- Organizatat e shoqërisë civile duhet të angazhohen në mënyrë të bashkërenduar me përfaqësuesit e qeverisë për përfshirjen e pikëpamjeve të qytetarëve në dialog meqë kjo do të kontribuojë në ndërtimin e konsensusit më të gjerë, besimit dhe ndjenjës së pronësisë ndaj procesit.
- Shërbimi evropian për veprim të jashtëm (EEAS) duhet të sigurojë që përmbajtja e takimeve të dialogut të komunikohet mirë dhe që çdo marrëveshje e arritur të publikohet në faqen e tij të internetit. Përveç kësaj, ky Shërbim duhet të sigurojë që transparenca dhe llogaridhënia të jenë parimet udhëheqëse të dialogut.
- Parlamenti i BE-së duhet të kërkojë debate të rregullta dhe raportime nga Përfaqësuesja e lartë për politikë të jashtme dhe siguri, Federica Mogherini, rreth procesit të dialogut si dhe rreth progresit e sfidave nga zbatimi i marrëveshjeve.
- Porositë në Beograd dhe Prishtinë duhet të kenë jehonën e porosive në Bruksel, dhe të mos jenë retorikë për konsum ditor në mënyrë që të zbusin potencialin për polarizim të mendimeve, dhe të krijimit të mosbesimit e tensioneve.
- Vizita zyrtare e ministrit të Punëve të Jashtme të Kosovës në Beograd është një fillim inkurajues, ku palët në dialog duhet të vazhdojnë shqyrtimin e të gjitha mundësive për vizita dhe mbledhje të ngjashme në Prishtinë dhe Beograd. Në këtë drejtim nevojiten përpjekje të harmonizuara për të siguruar që veprimet dhe porositë e tyre të jenë të matura dhe të ndjeshme ndaj gjuhës konfliktuoze, si dhe që të gjitha vizitat dhe deklaratat t'i kontribuojnë ndërtimit të mirëbesimit dhe marrëdhënieve të mira mes njerëzve.
- Qeveria e Kosovës, shoqëria civile dhe udhëheqësit politikë duhet të krijojnë dialog të rregullt me serbët e Kosovës në veri të Kosovës për t'i kuptuar shqetësimet e tyre dhe për t'u dhënë përkrahje në tejkalimin e sfidave ekzistuese dhe atyre të ardhshme.
- Dialogu duhet të përfshijë çështjen e personave të zhdukur – çështje kjo që kërkon vëmendje urgjente dhe serioze.

Për Saferworld

Saferworld është organizatë ndërkombëtare e pavarur, e cila punon në prandalimin e konflikteve dhe në krijimin e një jete më të sigurt.

Saferworld ka punuar në Ballkanin perëndimor që nga viti 2001, ndërsa zyrën në Kosovë e ka hapur në vitin 2005. Që nga ajo kohë, ne kemi kontribuar me sukses në bashkëpunimin dhe komunikimin mes shoqërisë civile dhe akterëve vendorë e të jashtëm, të cilët punojnë në sigurinë e komunitetit dhe në kontrollin e armëve të vogla dhe të lehta në Kosovë. Poashtu, ne kemi promovuar dialogun dhe bashkëpunimin mes organizatave të shoqërisë civile, profesionistëve të fushës, intelektualëve dhe autoriteteve në Ballkanin perëndimor lidhur me këto çështje.

Në kuadër të strategjisë së vet për Ballkanin perëndimor 2014-17, Saferworld ka për qëllim të fuqizojë dialogun dhe bashkëpunimin mes shoqërisë civile dhe akterëve vendorë e të jashtëm në proceset që kanë për qëllim ndërtimin e besimit dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda komuniteteve dhe mes tyre, si dhe mes shteteve në Ballkanin perëndimor, duke kontribuar kështu në paqen dhe sigurinë afatgjatë, si dhe në perspektivë më të mirë të regjionit për hyrje në BE.

Ne jemi organizatë joprofitabile dhe kemi programe në pothuajse 20 vende e territore në mbarë Afrikën, Azinë, Evropën dhe Lindjen e Mesme.

Saferworld – Rruga Hyzri Talla

Objekti 25, Villa nr 1, kati i tretë, Prishtinë, Kosovë

Personi kontaktues: Ferdinand Nikolla, koordinator i projektit për Kosovë

Tel: 381 (0) 38 545 222

Mob: + 377 (0) 44 171 845

E-mail: fnikolla@saferworld.org.uk

Web: www.saferworld.org.uk